



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2010

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

- Duke njohur e vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për sigurimin dhe kompensimin e depozitave të qytetarëve, të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë;

- Duke vlerësuar kontributin e saj në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit bankar;

- Duke vlerësuar rolin e kësaj agjencie për t'i siguruar Kuvendit, drejtuesve të institucioneve shtetërore dhe publikut në përgjithësi, një informacion cilësor e profesional mbi administrimin depozitave të qytetarëve;

- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë agjenci, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e saj me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

Vlerëson veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në drejtim të:

- Rritjes dhe konsolidimit të pozicionit të Agjencisë si institucion organizues, kontrollues dhe realizues i procesit të sigurimit dhe kompensimit të depozitave;

- Administrimit me efektivitet të mjeteve financiare të Agjencisë, nëpërmjet investimit të tyre në depozita pranë Bankës së Shqipërisë, letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare apo në letra me vlerë në monedhë të huaj të qeverive, bankave qendrore dhe institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare, mbështetur në parimet e minimizimit të riskut të investimeve dhe likuiditetit të portofolit;

- Edukimit dhe informimit të publikut për çështjet e sigurimit të depozitave, me qëllim funksionimin në mënyrë efektive të sistemit;

- Vendosijes dhe thellimit të bashkëpunimit me organizmat dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, në tërheqjen e politikave më të mira apo ofrimin e asistencës teknike të nevojshme.

Kuvendi kërkon që Agjencia e Sigurimit të Depozitave për vitin 2011 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Përmirësimin e politikave për sigurimin dhe kompensimin e depozitave, në zbatim të kuadrit ligjor në fushën e sigurimit të depozitave;

- Rritjen e bashkëpunimit me institucionet e specializuara, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës për realizimin e procesit të kompensimit të depozitave dhe në veçanti me Bankën e Shqipërisë, në drejtim të saktësisë së përlogaritjes së primit dhe vlerësimit të gjendjes financiare të institucioneve bankare, të siguruara pranë Agjencisë.

- Edukimin dhe informimin e mëtejshëm të pulikut për çështjet e sigurimit të depozitave;

- Përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e nënligjor për forcuar rolin e Agjencisë në krijimin e një sistemi sa më bashkëkohor të sigurimit të depozitave.

23 qershor 2011